

ZGJIDHJA E MARTESËS ME SHKURORËZIM

Me shkurorëzim zgjidhet vetëm martesë e vlefshme gjatë jetës bashkëshortore për shkaqe të parapara me ligj dhe në procedurë gjyqësore. Kompetente për zgjidhjen e martesës me shkurorëzim është gjykata themelore.

Martesa zgjidhet me aktgjykim; gjatë jetës së përbashkët të dy bashkëshorteve; shkaqet e shkurorëzimit duhet të jenë të parapara në ligj dhe procedura për zgjidhjen e martesës duhet të jetë e paraparë me ligj.

Klasifikimi i shkaqeve të zgjidhjes së martesës

Shkaqet për zgjidhjen e martesës me shkurorëzim klasifikohen në shkaqe të përgjithshme dhe në shkaqe të veçanta, në shkaqe absolute dhe në shkaqe relative; në shkaqe për të cilat e drejta e padisë fitohet pas kalimit të një afatit të caktuar dhe në shkaqe për të cilat e drejta e padisë nuk lidhet me një afat; në shkaqe të fshehta dhe shkaqet jo të fshehta; në shkaqe për të cilat e drejta në padi humbet pas kalimit të një afati dhe në shkaqe për të cilat e drejta në padi nuk humbet pas kalimit të një afati.

SHKURORËZIMI ME MARRËVESHJE

Dy bashkëshortët mund të akordohen për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, nëse janë marrëveshje njëri me tjetrin për zgjidhjen e saj. Zgjidhja e martesës me marrëveshje bëhet me propozim të dy bashkëshorteve para gjykatës kompetente. Zgjidhja me marrëveshje e martesës me fëmijë të mitur të përbashkët, të birësuar ose fëmijë ndaj të cilëve është vazhduar e drejta prindërore bëhet kur dy bashkëshortët parashtrajnë marrëveshje me shkrim për përkujdesje edukim dhe mbajtje të fëmijëve të përbashkët. Bashkëshortët duhen të paraqesin para gjykatës edhe marrëveshjen e përbashkët lidhur me kontaktet personale të bashkëshortit të cilit nuk i besohet fëmija në përkujdesje, edukim dhe mbajtje me fëmijën e tij.

Zgjidhja e martesës pa fëmijë të përbashkët me marrëveshje është e thjeshtë. Me këtë rast bashkëshortët nuk janë të detyruar që të paraqesin shkaqet për zgjidhjen e martesës.

PROCEDURA E SHKURORËZIMIT

Në kontestet për zgjidhjen e martesës zbatohen dispozitat e Ligjit për familjen dhe vetëm në rastet e veçanta kur këto dispozita mungojnë, zbatohen rregullat e procedurës civile. Parimet themelore të procedurës së shkurorëzimit janë:

1. Parimi i mbrojtjes së veçantë të disa personave në procedurë;
2. Parimi i përjashtimit të publikut;
3. Parimi i dispozicitetit, dhe
4. Parimi i kufizimit të disponimit me objektin e kontestit.

Në kontestet për zgjidhjen e martesës, vendos trupi i përbërë prej 1 gjyqtari profesionit dhe dy gjyqtarëve porotë, kurse në shkallë të dytë vendos kolegji i përbërë prej 3 gjyqtarëve profesionit.

Procedura për zgjidhjen e martesës fillon me padi kur vetëm njëri nga bashkëshortët kërkon zgjidhjen e martesës ndërsa bashkëshorti tjetër e kundërshton zgjidhjen e saj.

Paditësi ka të drejt ta tërheq padinë deri në përfundimin e seancës kryesore gjyqësore pa pajtimin e palës së paditur, kurse me pajtimin e të paditurit derisa procedura të përfundoj me aktgjykim të formës së prerë.

PËRPFJEKET PËR PAJTIM

Kur nuk kanë fëmijë të përbashkët përpjekjet për pajtim i bënë kryetari i trupit gjykues, kurse, po qe se bashkëshortët kanë fëmijë të përbashkët martesor, përpjekjet për pajtim i bënë organi i kujdestarisë. Procedura e pajtimit mund të zgjat tre muaj, nëse ka gjasa për pajtim kjo procedurë mund të zgjatet edhe për tre muaj të tjera, por jo më shumë se 6 muaj.

Gjykata mund ta zhvilloj procedurën për zgjidhjen e martesës edhe pa zhvilluar përpjekjet për pajtim, nëse dy bashkëshortët mungojnë në seancë përgatitore, po qe se janë ftuar në mënyrë të rregullt dhe mungesën nuk e arsyetojnë, nëse nuk u dihet adresa ose ndodhen në botën e jashtme.

CAKTIMI I MASËS SË PËRKOHSHME

Gjykata mund të caktoj sipas detyrës zyrtare me vendim masën e përkohshme për detyrimin e ushqimit, edukimi dhe arsimimit të fëmijëve. Në propozim të bashkëshorteve gjykata mund të caktoj me vendim masën e përkohshme për alimentacion, kur njëri nga bashkëshortët nuk ka mjete për ekzistencë kurse bashkëshorti tjetër ka mundësi ekonomike për pagesën alimentacionit.

MJETET E GODITJES TË AKTGJYKIMIT

Mjetet e goditjes të aktgjykimit për zgjidhjen e martesës janë dy llojesh:

- a) mjetet e zakonshme të goditjes dhe
- b) mjetet e jashtëzakonshme të goditjes

Mjet i zakonshëm i goditjes është ankesa. Ankesën e parashtron pala e pakënaqur kundër aktgjykimit. Ankesa ka efekt suspensiv dhe afati i paraqitjes së saj është 15 ditë nga dita e pranimit të aktgjykimit.

Shkaqet për paraqitjen e ankesës janë: *shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës civile; vërtetimi i gabueshëm dhe jo i plot i gjendjes faktike dhe zbatimi i gabueshëm i së drejtës materiale.*

Mjete e jashtëzakonshme nuk kanë karakter suspeziv dhe paraqiten kundër aktgjykimit të formës së prerë. Me mjete e jashtëzakonshme nuk mund të goditet pjesa e aktgjykimit të plotfuqishëm që ka të bëjë me zgjidhjen e martesës, por vetëm pjesët e aktgjykimit që kanë të bëjnë me alimentacionit dhe besimin e fëmijëve apo të bashkëshort, për kontaktet personale të prindërit të cilit nuk i është besuar fëmija në përkujdesje, arsimim dhe mbajtje, shpenzimet gjyqësore si dhe pjesë e aktgjykimit për besimin e fëmijës.

PASOJAT E ZGJIDHJES SË MARTESËS ME SHKURORËZIM DHE ANULIM

Pasojat e zgjidhjes së martesës ndahen në dy grupe themelore:

- a) pasojat personale juridike të zgjidhjes së martesës me shkurorezim për bashkëshortët, si:
 - mbiemri,
 - ndarja e pronës së përbashkët,
 - kthimi i dhuratave,
 - detyrimi i ushqimit,
 - e drejta e banesës,
 - e drejta e trashëgimit dhe
- b) pasojat juridike personale për fëmijët e përbashkët, të birësuar ose për fëmijë ndaj të cilëve është vazhduar e drejta prindërore.

Fëmijët me rastin e zgjidhjes së martesës i besohen:

- a) vetëm njërit prind në ruajtje, mbajtje dhe edukim, ndahen dhe dy prindërve i besohen fëmijët e përbashkët ose fëmijët besohet një personi tretë apo institucioni tjetër.

BASHKËSIA JASHTËMARTESORE

Bashkësia jashtëmartesore është bashkësi faktike midis burrit dhe gruas me qëllim të jetës së përbashkët. Bashkëshortët duhen të kenë jetuar në çift dhe të jenë me seks të kundërta.

Bashkësia jashtë martesore parapëlqehet nga gjeneratat e reja para se të lidhin martesë. Bashkësia jashtëmartesore themelohet me shprehjen e vullnetit në mënyrë joformale të një burri dhe një gruaje për jetës të përbashkët. Elementi konsultativ i bashkësisë jashtëmartesore është jeta e përbashkët dhe pa jetë të përbashkët nuk ka as bashkësi jashtëmartesore. Nga kjo rezulton se bashkëshortët në bashkësi jashtëmartesore bëjnë jetë të përbashkët si bashkëshortet në bashkësi martesore.

Për jetën e personit gjatë 5 vjetëve të fundit të mos ketë pasur kurrfarë informatash, veçoritë e bashkësisë jashtëmartesore;

- a) njohja ose notariteti që nënkupton ekzistimin e njohjes së çiftit nga mjedisi ku jetojnë se ata jetojnë në bashkësi jashtëmartesore
- b) monogamia që nënkupton se bashkësia jashtëmartesore është bashkësi e një burri dhe një gruaje. As një person nuk mund të jetë njëjtën kohë më shumë se një bashkësi jashtëmartesore.
- c) Sekset e kundërta si edhe në bashkësi jashtëmartesore sekset e bashkëshorteve duhen të jenë të kundërta ngase edhe këtu kryhen marrëdhënie intime mes bashkëshorteve dhe lindin fëmijë.

Bashkësia jashtëmartesore është bashkësi e vazhdueshme e themeluar me vullnetin e shprehur të një burri dhe të një gruaje që vazhdojnë që të jetojnë për një kohë të gjatë së bashku në bashkësi jashtëmartesore pa lidhur martesë civile.

LLOJET E BASHKËSISË JASHTËNMARTESORE

Në literaturë juridike janë të njohura disa lloje të bashkësisë jashtëmartesore:

- Bashkësia jashtëmartesore e çastit ose sporadike;
- E përkohshme;
- E përhershme;
- Jo stabile dhe
- Stabile

Rregullimi juridik i bashkësisë jashtëmartesore.

Deri vonë bashkësia jashtëmartesore nuk ka qenë e rregulluar me ligj sepse, si ka thënë Napoleon Banaparta: “bashkëshortët jashtëmartesor nuk i nënshtrohen ligjit, ligji për ta nuk interesohet”. Shumë të drejta të vendeve të ndryshme, të cilat ishin nën ndikimin e së drejtës franceze, bashkësinë jashtëmartesore nuk e rregulluan me norma ligjore. Ligji ynë për familjen pjesërisht e ka rregulluar bashkësinë jashtëmartesore, dhe atë në pjesën që ka të bëjë me detyrimin e ushqimit, pasurinë e përbashkët të bashkëshorteve jashtëmartesore si dhe barazimin e fëmijëve të lindur në bashkësi martesore me fëmijët e lindur në martesë.

MBARIMI I BASHKËSISË JASHTËNMARTESORE

Bashkësia jashtëmartesore mbaron në mënyrë natyrore me vdekjen e njërit apo të dy bashkëshorteve; me shpalljen i zhdukur si i vdekur të njërit apo të dy bashkëshorteve; me marrëveshje të dy anshme të bashkëshorteve ose heshtazi kur dy bashkëshortët nuk jetojnë më në bashkësi jashtëmartesore pa i shpallur njërit tjetrit mbarimin e bashkësisë jashtëmartesore.

PASOJAT E MBARIMIT TË BASHKËSISË JASHTËMARTESORE

Pas mbarimit të bashkësisë jashtëmartesore shkaktohen tri lloj pasojash:

- a) Pasojat e natyrës personale pasurore, ushqimit të detyrueshëm,
- b) Pasojat e natyrës pasurore, pjesëtimi i pasurisë së përbashkët dhe
- c) Pasojat për fëmijë të përbashkët të lindur në bashkësi jashtëmartesore

Marrëdhëniet pasurore juridike të prindërve dhe fëmijëve

Marrëdhëniet pasurore juridike të prindërve dhe fëmijëve lindin si pasojë e jetës së përbashkët në një familje dhe e kujdesit të ndërsjellët, jo në bazë të një kontrate. Fëmija mund të ketë pasuri vetjake, të cilën mund ta ketë fituar në mënyrë të ligjshme, me dhurim, trashëgim, lojra fati dhe me punë, si aktor në teatër, film, muzikë , e tj.

Pasurinë e fëmijës e administrojnë bashkërisht dhe me marrëveshje dy prindërit në dobi të fëmijës, ata duhet ta administrojnë si nikoqir të mirë. Titullar i pasurisë së fëmijës së mitur është vetë fëmija.

Të drejtat dhe detyrat e fëmijëve

Detyrat e prindërve janë në raport korelativ me të drejtat e fëmijëve: secili detyrim i prindërve është në të njëjtën kohë e drejtë e fëmijëve. P. sh. Prindërit kanë për detyrë të kujdesen për ruajtje dhe mirërritjen, mbajtjen dhe administrimin e pasurisë së fëmijëve, kurse fëmijët kanë të drejtë të kërkojnë nga prindërit realizimin e këtyre të drejtave.

Detyrat e fëmijëve ndaj prindërve janë:

- a) Ligjore. Fëmijët kanë detyrë ligjore që të kujdesen për prindërit e tyre, sidomos kur ata janë të pafatë për punë dhe nuk kanë mjete të mjaftueshme për jetesë, ose janë të sëmurë dhe për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike nuk mund të kujdesen vetë për vetën e tyre.
- b) Detyrat morale. Respektimi dhe nderimi i prindërve është element pozitiv i traditës sonë shekullore dhe një detyrë themelore për secilin fëmijë. Mirësjellja ndaj prindërve është detyrë morale e të gjithë fëmijëve.

Edhe personat gjini kanë detyrë të mbajnë fëmijët, si në gjini gjaku, të birësimit edhe të krushqisë.

USHTRIMI I SË DREJTËS PRINDËRORE

E drejta prindërore u përket vetëm prindërve (nënes dhe atit), është e drejtë personale dhe nuk mund të trashëgohet e as të mbartetet në persona tjerë. Prindërit duhet t'i ushtrojnë të drejtat prindërore në interes të fëmijëve, kur nuk gjejnë mirëkuptim me fëmijën atëherë zgjidhjen e çështjeve kontestuese e zgjidhë organi i kujdestarisë.

Pezullimi i së drejtës prindërore mund të bëhet për shkak të dy lloj pengesash: a) pengesat faktike dhe b) pengesat juridike.

Kufizimi i së drejtës prindërore bëhet kur prindërit duke u sjell në mënyrë të papërgjegjshme, abuzojnë të drejtat prindërore dhe rrezikojnë personalitetin e fëmijëve, të drejtat dhe interesat e tyre.

Organi i kujdestarisë, sipas detyrës zyrtare, ndërmerr masa adekuate për mënjanimin e shkeljeve dhe çrregullimeve të shkaktuara në sjelljet e prindërve, si:

- Tërheqjen e vërejtjes;
- Kujdesin e përhershëm për ushtrimin e të drejtave prindërore;
- Marrjen e fëmijës nga prindërit;
- Dërgimin e fëmijës në institucion;

Kufizimi i të drejtave prindërore lidhur me të drejtat dhe detyrat ndaj pasurisë së fëmijëve:

- Detyrimi i dhënies së llogarisë për administrimin e pasurisë së fëmijëve
- Lejimi i mjeteve të sigurimit mbi pasurinë e prindit;
- Barazimin e pozitës së prindërit me pozitën e kujdestarit lidhur me administrimin e pasurisë

-

HEQJA E TË DREJTËS PRINDËRORE

Prindërit të cilët keqpërdorin të drejtat prindërore, ose që në mënyrë serioze neglizhojnë ushtrimin e të drejtës prindërore, i hiqet (privohet) nga e drejta prindërore.

Vendimin për heqjen e së drejtës prindërore e merr gjykata themelore në procedurë jokontestimore, vetëm për shkaqe të parapara shprehimisht me ligj. Procedura është urgjente dhe duhet të përfundoj jo më vonë se 15 ditë nga dita e paraqitjes së propozimit.

Pasojat e heqjes së drejtës prindërore.

Kur një prindëri i hiqet e drejta prindërore, ai nuk mund të ushtroj më të drejtat lidhur me mirërritjen, edukimin, shkollimin, administrimin e pasurisë së fëmijës. Prindërve u kthehen të drejtat prindërore kur pushojnë së ekzistuari shkaqet për të cilat e drejta prindërore është hequr.

VAZHDIMI I SË DREJTËS PRINDËRORE

E drejta prindërore vazhdohet edhe pas mbushjes së moshës madhore në rastet e parapara me ligj, kur fëmija nuk është i aftë të kujdeset për interesat e veta. Vendimin për vazhdimin e të drejtës prindërore e merr gjykata në procedurë jokontestimore, por në atë mënyrë si me rastin e heqjes dhe rikthimin e së drejtës prindërore.

Procedura për vazhdimin e së drejtës prindërore zhvillohet pranë gjykatës themelore dhe zbatohen dispozitat e ligjit të procedurës jokontestimore. Kur një fëmijë i vazhdohet e drejta prindërore prindërit edhe më tutje vazhdojnë ti ushtrojnë të drejtat prindërore ndaj fëmijëve edhe pas mbushjes së moshës madhore, njësoj sikur ata të ishin fëmijë të mitur.

Vazhdimi i së drejtës prindërore mbaron kur pushojnë shkaqet për të cilat është vazhduar e drejta prindërore me vendim të gjykatës.

Mbarimi i së drejtës prindërore.

E drejta prindërore mbaron kur fëmija fiton zotësinë e plotë të veprimit me mbushjen e moshës madhore; birësimin e fëmijës; me emancipim dhe me vdekjen e njërit prej subjekteve të së drejtës prindërore.

BIRËSIMI

Qëllimi i birësimit është përkujdesja ndaj fëmijëve bonjak, pa përkujdesje prindërore, vendosja në familje me qëllim të mirërritjes dhe edukimit. E drejta romake ka njohur dy lloje të birësimit: birësimi i plotë (adoptio plena) dhe birësimi jo i plotë (adoptio semi plena) Ligji i familjes së Kosovës nuk bënë ndarjen e birësimit në birësim të plotë dhe jo të plotë.

Veçori e birësimit, sipas dispozitave të këtij ligji, është se ky birësim është i shkëputshëm. I birësuarit trashëgon birësuarin dhe, në pikëpamje të drejtave dhe detyrave, barazohet me fëmijët e të birësuarit. Në mes të fëmijës së birësuar dhe birësuarit krijohen marrëdhëniet e njëjta si ndaj prindërve dhe fëmijëve.

KUSHTET PËR THEMELIMIN E BIRËSIMIT

Sipas ligjit për familjen për themelimin e birësimit duhet të plotësohet këto kushte:

- a) Që fëmija të ketë lindur i gjallë; që fëmija të jetë i mitur; që fëmija të mos jetë në gjini të gjakut me birësuesin; që fëmija mbi moshën 14 vjeçare ta ketë dhënë pëlqimin për birësim.

- b) Birësues mund të jetë personi që ka zotësinë e veprimit; që ka cilësi personale të nevojshme për ushtrimin e suksesshëm të drejtave dhe detyrave prindërore, dhe të jetë i aftë për mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve; të mos vuaj nga sëmundje ngjitëse që do të rrezikonin shëndetin e fëmijës; që të ketë mbushur moshën 21 vjeçare; nëse fëmijën e birësojnë dy bashkëshortët njëri prej bashkëshorteve duhet ta ketë mbushur moshën 25 vjeçare, ndërsa bashkëshorti tjetër 21 vjeç.

Birësimi themelohet në procedurë jokontestimore para gjykatës themelore me parashtrimin e propozimit nga prindi birësues. Nga seanca përjashtohet publiku. Me dispozita ligjore përcaktohet periudha provuese ku fëmija vendoset në familjen e personit që kërkon ta birësoj dhe mbikëqyret nga organi i kujdestarisë nëse ai mund të përshtatet dhe të ambientohet në familjen e personit që kërkon ta birësoj, ose jo.

Gjykata do të konstatoj në procesverbal themelimin e birësimit. Nëse fëmija është më i vjetër se 10 vjet merr pjesë në aktin e themelimit të birësimit. Nëse gjykata gjen se me themelimin e birësimit do të dëmtohen interesat e fëmijës do ta refuzoj themelimin e birësimit.

Kundër vendimit mbi refuzimin e birësimit mund të parashtrohet ankesë në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit.

Pas themelimit të birësimit prindërit biologjik nuk mund ti ushtrojnë më të drejtat dhe detyrimet ndaj fëmijëve të tyre, edhe nëse ata janë gjallë.

SHUARJA E BIRËSIMIT

Shuarja e birësimit bëhet po qe se për çfarëdo arsye kjo bëhet e nevojshme. P.sh. prindi biologjik është i pajtimit ta marr përsipër kujdesin dhe mirërritjen e fëmijës; nëse fëmija është birësuar nga çifti bashkëshortor birësimi mund të mbaroj vetëm me njërin nga bashkëshortët.

Pasojat e shuarjes së birësimit

Pasojat e shuarjes së birësimit nuk i ka rregulluar shprehimisht Ligji për familjen i Kosovës. Pas pushimit të birësimit fëmija i birësuar do ta gëzonte detyrimin e ushqimit nga birësuesi, ndërsa prindërit biologjik do ti ushtrojnë të drejtat prindërore.

ANULIMI I BIRËSIMIT

Ekziston anulimi objektiv dhe subjektiv i birësimit. Anulimi objektiv ekziston kur me rastrin e lidhjes së birësimit nuk është plotësuar ndonjë kusht i paraparë ligjor për birësimin: mituria e fëmijës, vetit personale të birësuesit, pëlqimi i personave të autorizuar.

Anulimi subjektiv ekziston nëse pëlqimi i personave të autorizuar është dhënë nën kërcenim apo lajthim.

PASOJAT E ANULIMIT TË BIRËSIMIT

Gjykata me aktvendim për anulimin e birësimit birësuesit i cakton mbajtjen e detyrueshme deri sa ai ti mbush moshën madhore. Me detyrimin e ushqimit ngarkohet birësuesi ndërsa lartësia caktohet duke marr parasysh gjendjen ekonomike të birësuesit si dhe nevojat e fëmijës.

DETYRIMI PËR USHQIM

Detyrimi për ushqim është e drejtë e personave në nevojë që të kërkojnë gjithçka të nevojshme për përmbushjen e nevojave të domosdoshme për jetës. Debitori është pala që e jep ushqimin kurse kreditori është pala që kërkon ushqimin e detyrueshëm. Detyrimi për ushqim është detyrim ligjor. Quhet detyrim ligjor sepse buron drejtpërdrejt nga ligji, është rregulluar me dispozita kogente.

Detyrimi për ushqim është detyrim dhe e drejt personale ngase lidhet ngushtë si me personin e detyruar për dhënien e ushqimit ashtu edhe me personin që e gëzon këtë të drejt. Një person pikërisht pse është atë apo nënë është i detyruar që fëmijëve të vetë t' u jep ushqimin.

Nuk mund të hiqet dorë nga detyrimi për ushqim dhe heqja dorë nga ushqimi nuk shkakton efekte juridike. Nëse personi që ka të drejt në ushqim nuk e shfrytëzon këtë të drejtë për një kohë, nuk e humb të drejtën që këtë të drejtë ta shfrytëzoj më vonë.

Detyrimi për ushqim nuk parashkruhet por parashkruhen kështu e arritura për pagesë.

Ushqimi i jepet për kohën e ardhshme dhe caktohet me vendim gjyqësor. Me ndryshimin e rrethanave vendimi gjyqësor i formës së prerë mund të ndryshohet në përshtatje me kushtet e reja.

Detyrimi për ushqim i paguar njëherë nga prindërit nuk mund të kthehet sepse ai nuk konsiderohet dhuratë, hua apo edhe ndonjë punë tjetër bamirëse juridike.

Detyrimi për ushqim nuk është dëmshpërblim por ka përparësi sa i përket përmbartimit kundrejt kërkesave të tjera.

LLOJET E DETYRUIMIT TË USHQIMIT

Ligji ynë për familjen njeh këto lloje të detyrimit të ushqimit

- Detyrimi i ushqimit për fëmijë;
- Detyrimi i ushqimit mes bashkëshorteve gjatë martesës dhe pas zgjidhjes së martesës;
- Detyrimi i prindërve për ty ushqyer fëmijët;
- Detyrimi i atit të pamartuar për ta ushqyer fëmijën;
- Detyrimi i fëmijëve për ti ushqyer prindërit;
- Detyrimi i ushqimit mes të paralindurve dhe pas lindurve;

- Detyrimi i ushqimit mes personave gjini të krushqisë;
- Detyrimi i ushqimit mes personave gjini të birësimit.

Lartësinë e detyrimit të ushqimit e cakton gjykata me aktvendim.

Detyrimi për ushqim shuhet kur pushojnë rrethanat për të cilat është caktuar; me kalimin e afatit për të cilin është caktuar me vdekjen e personit që ka pasur detyrim për dhënien e ushqimit; kur gjendja ekonomike e marrësit të ushqimit përmirësohet.

MARRËDHËNIET PASURORE MES BASHKËSHORTEVE

Marrëdhëniet pasurore mes bashkëshorteve rregullohen me norma juridike të ligjit të familjes së Kosovës. Ligji i familjes së Kosovës ka paraparë regjimin pasuror të bashkëshorteve i cili përbehet:

- a) Pasuria e veçantë e cila është ajo pasuri të cilin bashkëshorti e ka pasur momentin e lidhjes së martesës si dhe pasuria të cilin e ka fituar gjatë bashkësisë martesore në çfarëdo mënyre të lejuar por jo me punë. P.sh. me trashëgimi me dhurim, me shpërblim të dëmit vetjak etj.
- b) Pasuria e përbashkët pasuria e përbashkët e bashkëshorteve është pasuri e fituar me punë gjatë vazhdimit të martesës, si dhe të hyrat që rrjedhin nga pasuria e tillë. Për ekzistimin e pasurisë së përbashkët duhet të ekzistojnë dy kushte: ekzistimi i bashkësisë martesore dhe punë e përbashkët e bashkëshorteve martesore. Objekt i pasurisë së përbashkët mund të jetë si sendet e luajtshme edhe të paluajtshme, të drejtat reale si servitudet pastaj e drejta e pengut pasuria e etazhit etj.

Pasurinë e përbashkët e administrojnë dhe e disponojnë dy bashkëshortët me marrëveshje. Pjesëtimi dhe ndarja e pasurisë së përbashkët e bashkëshorteve mund të bëhet si gjatë martesës ashtu edhe pas zgjidhjes së saj. Nëse bashkëshortët nuk mund ta pjesëtojnë me marrëveshje pasurinë e përbashkët atëherë për këtë vendos gjykata në procedurë jokontestimore nëse pjesët nuk janë kontestuese, nëse pjesët janë kontestuese atëherë vendos gjykata si pas rregullave të procedurës civile.

KUPTIMI I SË DREJTËS SË KUJDESTARISË

Qëllimi i kujdestarisë është mbrojtja e personalitetit, pasurisë, të drejtave dhe interesave të personave të mitur dhe personave të tjerë, të cilit nuk janë në gjendje të kujdesen për veten e tyre. Organi i kujdestarisë veprimtarinë e vetë e kryen në dy mënyra;

- a) Të drejtpërdrejt, kur vet organi i kujdestarisë pa pjesëmarrjen e personave të tjerë i kryen detyrat e kujdestarit, dhe

- b) Në mënyrë të tërthortë kur organi i kujdestarisë e emëron një kujdestar për kryerjen e punëve dhe detyrave të kujdestarit.

Kujdestarin e emëron dhe e shkarkon organi i kujdestarisë. Si kujdestar mund të jetë çdo person i cili ka cilësitë personale dhe aftësitë e nevojshme për përmbushjen e detyrat të kujdestarit dhe i cili më parë jep pëlqimin që të bëhet kujdestar. Detyrat e kujdestarit është që të kujdeset me mirëbesim për personalitetin, të drejtat dhe interesat e të kujdestarit ta administroj pasurinë e tij me kujdes si dhe ta informoj organin e kujdestarisë për udhëheqjen e kujdestarisë. Shkarkimi i kujdestarit bëhet kur ai ka keqpërdor autorizimin e tij si kujdestar ka shkelur interesat e personit në kujdestari ose ka abuzuar me pasurinë e të miturit.

Kujdestari përgjigjet sipas rregullave të procedurës civile për shkaktimin e dëmit të kujdesuarit ndërsa sipas Kodit penal për vepra penale të kryera kundër fëmijës. Ligji ynë njeh kujdestarinë individual, kujdestarin e entit, kujdestarinë e përbashkët, kujdestarin themelore, kujdestarin e personit dhe kujdestarin e pasurisë. Kujdestarinë e përkohshëm dhe të përhershëm.

Ekzistojnë tri lloje të kujdestarisë:

- a) Kujdestaria ndaj fëmijëve të mitur. Fëmijët e mitur pa përkujdesje prindërore ose të cilëve i është hequr e drejta prindërore vihen në kujdestari dhe organi i kujdestarisë ua cakton kujdestarinë
- b) Kujdestaria ndaj personave me zotësi të hequr veprimi personave të paaftë për të gjykuar, për shkaqe të ndryshme, dhe të cilët me veprimet e tyre rrezikojnë të drejtat dhe interesat e tyre vihen në kujdestari. Paaftësia për gjykim normal është shkaku i vendosjes së këtyre fëmijëve nën kujdestari ndërsa paaftësia për përkujdesje të mëvetësishme për të drejtat dhe interesat e veta është pasoja.
- c) Rastet e veçante të kujdestarisë me kujdestarinë për rastet e veçante mbrohen vetëm disa të drejta personale apo pasurore si kur pronari i pasurisë është i panjohur, kur interesat e prindërve janë të kundërta në kontestet që zhvillohet midis tyre etj. Kujdestar rastet e veçante të kujdestarisë mund të emërohet: kujdestari i pasurisë së pronarit të panjohur; kujdestari i personit që mungon, kujdestari i shtetasit të huaj, kujdestari i personit të sëmuar, kujdestari i personit të privuar nga liria, kujdestari vullnetar.

SHUARJA E KUJDESTARISË

Kujdestaria shuhet në dy mënyra:

- 1) Me vdekjen e të kujdestarit dhe në mënyrë juridike me kthimin e zotësisë për të vepruar të personit me zotësi të hequr të veprimit.

Ligjërata nga E drejta familjare dhe trashëgimore

MARRËDHËNIET MES PRINDËRVE DHE FËMIJËVE

Marrëdhëniet mes prindërve dhe fëmijëve i karakterizojnë tri elemente themelore:

- a) Elementi natyror
- b) Elementi shoqëror
- c) Elementi juridik

Subjektet e së drejtës prindërore janë

1. Prindërit. Prindërit janë persona fizik biologjikisht të aftë për të lindur fëmijë. Nëna e fëmijës konsiderohet gruaja e cila e ka lindur, ndërsa atë personi prej të cilit është zënë fëmija.
2. Fëmijët. Fëmijët janë persona të mitur të cilët nuk e kanë mbushur moshën 18 vjet. Derisa fëmija të mbush moshën madhore dhe ta fitoj zotësinë e veprimit ai gëzon vetëm të drejta. Vetëm në raste të përcaktuara në ligj ka edhe detyrime.

Vërtetimi i statusit martesor të fëmijës.

Një fëmijë ka status martesor nëse i plotëson këto kushte:

- Të ketë prejardhje nga martesa e prindërve;
- Ta ketë lindur gruaja në martesë;
- Ati i fëmijës të jetë burri i nënës që ka lindur fëmijën

Prejardhja martesore e fëmijës

Fëmija është martesor nëse ka lindur gjatë martesës apo që ka lindur brenda 300 ditësh pas zgjidhjes së martesës.

Fëmija ka statusin martesor nëse e ka lindur gruaja e cila në momentin e lindjes së fëmijës ka qenë në martesë.

Fëmija ka statusin martesor nëse është zënë me farën e burrit martesor të gruas, e cila e ka lindur.

Kundërshtimi i amësisë

Janë të radha në praktik rastet kur kundërshtohet amësia. Nëna si rregull është gjithmonë e njohur që nga momenti i zënies mbartjes së shtatzënisë dhe lindjes së fëmijës. Nëna e fëmijës regjistrohet në librat amzë me rastin e regjistrimit të fëmijës si nënë e prezumuar. Megjithatë ndodhë që nëna e prezumuar dhe e regjistruar në librat amzë të të lindurve të mos jetë nëna biologjike e fëmijës. Për shkak të ndërrimit të foshnjave në spital me apo pa qëllim apo kur vjedhjet foshnja nga një grua tjetër me qëllim të trafikimit me qenien njerëzore.

E drejta e padisë për kundërshtimin e amësisë u takon këtyre personave:

- a) Gruas e cila është regjistruar në regjistrin amë të të lindurve si nënë e fëmijës. Kjo grua padinë mund ta paraqesë brenda afatit 6 mujor nga dita kur merr në dijeni aktin se ajo nuk është nëna e fëmijës, por jo më shumë se 7 vjet nga lindja e fëmijës.
- b) Gruas e cila e konsideron vetën nënë të fëmijës. Në padi duhet të parashtroj dy kërkesëpadi me njërën t'ia kundërshtoj amësinë gruas e cila në regjistrin amë të të lindurve është regjistruar si nënë e fëmijës, ndërsa me të dytën të kërkoj që të vërtetohet se ajo është nëna biologjike e fëmijës. Padinë mund ta paraqet në afatin 6 mujor nga dita kur merr vesh se ajo është nënë e fëmijës, por jo më shumë se 7 vjet nga lindja e fëmijës.
- c) Nga fëmija mund të paraqitet padia nga momenti kur e merr në dijeni se nëna e regjistruar në librat amzë të të lindurve si nënë e tij nuk është nëna e vërtetë që e ka lindur. Në emër të fëmijës padinë mund ta paraqet kujdestari me leje të organit të kujdestarisë. E drejta në padi nuk vjetërsohet.

Kundërshtimi i atësisë

Qëllimi i kundërshtimit të atësisë është që të vërtetohet se burri i nënës së fëmijës nuk është edhe ati natyror i fëmijës. Atësinë mund ta kundërshtojnë:

- a) Nëna e prezumuar e fëmijës brenda afatit prej 6 muajsh nga lindja e fëmijës kur merr në dijeni se ati i prezumuar i fëmijës nuk është ati biologjik i tij.
 - b) Fëmija kur merr në dijeni se ati i prezumuar nuk është ati biologjik i tij. Padinë në emër të tij mund ta paraqet nëna, e nëse nëna nuk është e gjallë apo ka vendqëndrim të panjohur, ose i është hequr aftësia për të vepruar apo e drejta prindërore kujdestari i tij me leje të organit të kujdestarisë.
 - c) Personi që e konsideron veten atë të fëmijës jashtëmartesor në afatin prej 1 viti nga regjistrimi i atësisë së kundërshtuar në regjistrin amë të të lindurve. Ky person me padi duhet të paraqes dy kërkesëpadi: me njërën të kundërshtoj atësisë e personit të regjistruar si atë i prezumuar të fëmijës, ndërsa me të dytën të kërkoj që të vërtetohet atësia e tij.
- ç) burri i nënës së fëmijës mund të paraqet padi brenda afatit prej 6 muajsh nga dita e marrjes në dijeni të faktit që vënë në dyshim atësinë e tij, nëse mund të vërtetohet se në kohën e zënies së fëmijës nuk ka pasur marrëdhënie seksuale me gruan e tij e cila e ka lindur fëmijën.

Procedura për kundërshtimin e atësisë

Në procedurën për kundërshtimin e atësisë zbatohen rregullat e procedurës civile. Në procedurën për kundërshtimin e atësisë merren këto prova:

- a) Provat juridike
- b) Provat mjekoligjore

Me prova juridike vërtetohet koha e zënies së fëmijës. Shtatzënia më e shkurtër është 180 ditë, ndërsa më e gjata është 300 ditë. Nëse vërtetohet se brenda shtatzënisë më të gjatë burri i nënës së fëmijës nuk ka pasur marrëdhënie seksuale me nënën e fëmijës, përjashtohet mundësia që ky të jetë ati biologjik i fëmijës që e ka lindur gruaja e tij. Pra me metodën juridike vërtetohet momentin i zënies së fëmijës dhe në qoftë se në atë moment burri i nënës së fëmijës ka qenë jashtë vendit apo në mbajtje të dënimit me burg gjithashtu vërtetohet se ai nuk është ati biologjik i fëmijës.

Gjithashtu me prova mjekoligjore mund të vërtetohet lehtë se ati i prezumuar i fëmijës nuk është ati biologjik i fëmijës. Me anë kombinimeve të grupeve të gjakut (a,b,ab dhe o) nën grupeve (a1, a2, b1, b2 dhe faktorëve të gjakut (N, M, NM, G, H, R, Q) mund të përjashtohet mundësia që burri i nënës së fëmijës të jetë ati i fëmijës. P.sh. nëse nëna e fëmijës e ka grupin e gjakut A ndërsa ati B fëmija duhet ta ketë grupin e gjakut AB. Nëse fëmija e ka grupin e gjakut O atëherë përjashtohet mundësia që ati i prezumuar i fëmijës të jetë edhe ati biologjik i fëmijës.

Pasojat e kundërshtimit të atësisë

Aktgjykimi ka karakter konstitutiv sepse ndryshohen marrëdhëniet juridike midis atit dhe fëmijës. Fëmija e ndryshon statusin e tij, prej fëmijës me status martesor kalon në fëmijë me status jashtëmartesor dhe tani ati biologjik i tij nuk dihet. Ofiqari i gjendjes civile duhet ta bëjë ndryshimin në regjistrat amë të ët lindurve.

Vetëm kur një person me sukses ia kundërshton atësinë atit të prezumuar dhe vërteton se ai është ati biologjik i fëmijës, fëmija ka të vërtetuar atësinë jashtëmartesore.

Fëmijët jashtëmartesor

Historikisht fëmijët jashtëmartesor kanë pas pozitë diskriminuese në familje dhe në shoqëri. Tani, si rrethoj e ndikimit të së drejtës ndërkombëtare mbi të drejtën e brendshme të një vendi,

pozita e fëmijëve jashtëmartesor është përmirësuar dukshëm. Me dispozitat e Ligjit për familjen të Kosovës pozita e fëmijëve jashtëmartesor është barazuar me pozitën e fëmijëve martesor në pikëpamje të drejtave dhe detyrave. Fëmijë jashtëmartesor quhen:

- Çdo fëmijë që e ka lindur gruaja e pamartuar;
- Çdo fëmijë që e ka lindur gruaja e ve pas kalimit të afatit prej 300 ditësh nga dita e zgjidhjes së martesës;
- Çdo fëmijë që e ka lindur gruaja e martuar gjatë martesës nëse atësia e fëmijës është kundërshtuar gjyqësisht me aktgjykim të formës së prerë.

Mund të ndodh që një fëmijë të mos i dijet ati apo nëna apo që të dy bashkë. Prandaj në rastet e tilla, vërtetimi i marrëdhënieve prindërore bëhet:

- a) Me njohjen e amësisë. Njohja e amësisë është një veprim juridik i njëanshëm i një gruaje, e cila shpreh vullnetin e lirë ligjërisht se ajo është nëna e fëmijës të lindur jashtë martese. Njohja e amësisë nuk është e rregulluar me dispozita ligjore.
- b) Njohja e atësisë është një aktit i njëanshëm juridik me anë të cilit një mashkull shpreh në mënyrë valide vullnetin e vetë se ai është ati i fëmijës jashtëmartesore. Ky person duhet ta ketë zotësinë e veprimit.
- c) Njohja e atësisë dhe amësisë në procesverbal para gjykatës. Procesverbalin për njohjen e atësisë dhe amësisë gjykata është e detyruar t'ia dërgoj zyrtarit të gjendjes civile.

Procedurat për njohjen e atësisë. Kjo procedurë është mjaft e thjeshtë dhe personi që vetën e konsideron atë të fëmijës mund ta pranoj atësinë në njërën nga këto mënyrat:

- Duke deklaruar në procesverbal para zyrtarit të gjendjes civile se e njih atësinë e fëmijës jashtëmartesor;
- Duke deklaruar në procesverbal para organit të kujdestarisë se e njih atësinë e fëmijës jashtëmartesor;
- Duke deklaruar në procesverbal para gjykatës se e njih atësinë e fëmijës jashtëmartesor, dhe
- Me testament

Kushtet për njohjen e atësisë

- a) Që fëmija të ketë lindur i gjallë;
 - b) Pëlqimi i nënës së fëmijës;
 - c) Pëlqimi i fëmijës. Që fëmija ta jep pëlqimin në mënyrë valide duhet të kelt mbushur moshën 16 vjeçare;
- Ç) zotësia për të vepruar e personit që e pranon atësinë e fëmijës;

Efektet juridike të njohjes së atësisë

Me rastin e njohjes së atësisë vendosen marrëdhëniet prindërore mes atit dhe fëmijës jashtëmartesor. Fëmija vendoset në familjen e atit që ka njohur si të vetin fëmijën dhe merr mbiemrin e atit. Njohja e atësisë vepron “ex tunc” që dmth nga lindja e fëmijës.

Anulimi i atësisë së njohur

Nëse nuk kanë qenë kushtet ligjore të plotësuara mund të anulohet atësia e njohur. Anulimin absolut të atësisë së njohur e kemi kur nuk kanë qenë të plotësuara kushtet e parapara ligjore si: fëmija i mitur ka dhënë pëlqimin për njohjen e atësisë para mbushjes së moshës 16 vjeçare; nëna e fëmijës nuk ka dhënë pëlqimin mbi njohjen e atësisë; fëmija të cilit i është njohur atësia ka lindur i vdekur dhe kur deklarata mbi njohjen e atësisë nuk është bërë në formën e paraparë me dispozita ligjore.

Anulimi relativ i atësisë së njohur ekziston kur deklarata mbi njohjen e atësisë është dhënë me shtrëngim, me lajthim apo me mashtrim.

Kundërshtimi i atësisë së njohur mund të bëhet nga nëna e fëmijës, fëmija, burri i nënës së fëmijës dhe personi që veten e konsideron atë të fëmijës. E drejta e parashtrimit të padisë për kundërshtimin e atësisë së njohur parashkruhet në afatin prej 1 viti nga regjistrimi i atësisë në regjistrat e gjendjes civile.

Vërtetimi i amësisë me vendim të gjykatës

Vërtetimi i amësisë me vendim të gjykatës nuk është rregulluar me dispozitat të ligjit të familjes, për arsye se nëna është emocionalisht e lidhur me fëmijën e saj dhe shumë vështirë vendos për braktisjen e fëmijës së vetë. Kur kemi të bëjmë me vërtetimin e amësisë me vendim të gjykatës zbatohen në mënyrë analoge dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me vërtetimin e atësisë me vendim gjyqësor.

Vërtetimi i atësisë me vendim të gjykatës

Vërtetimi i atësisë me vendim të gjykatës është i rregulluar me dispozitat e Ligjit të familjes të Kosovës. Detyrë e gjykatës është që të vërtetoj me prova valide se fëmija i lindur është zënë me farën e burrit të nënës së fëmijës.

Padinë mund ta parashtrojnë nëna e fëmijës, fëmija organi i kujdestarisë dhe personi i cili veten e konsideron atë të fëmijës.

Efektet e vërtetimit të atësisë jashtëmartesore

Me vërtetimin e atësisë jashtëmartesore vendosen marrëdhëniet prindëror midis atit dhe fëmijës. Fëmija ka të drejt të marr mbiemrin e atit. Statusi i fëmijës nuk ndryshon: statusi jashtëmartesor që fëmija kishte fituar me lindje do të mbetet edhe më tutje edhe pas vërtetimit të atësisë martesore.

E DREJTA PRINDËRORE

E drejta prindërore është tërësi e rregullave juridike me të cilat rregullohen marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve, midis birësuesit dhe të birësuarit, midis kushërirëve dhe personave të tjerë në gjini.

Të drejtat dhe detyrat e prindërve ndaj fëmijëve janë të dy llojta:

- a) Të drejtat dhe detyrat personale të prindërve ndaj fëmijëve dhe
- b) Të drejtat dhe detyrat pasurore të prindërve ndaj fëmijëve.

Të drejtat dhe detyrat e prindërve mbarojnë kur fëmija mbush moshën madhore, kur bëhet i aftë të kujdeset për vete, për të drejtat dhe interesat e veta.

Të drejtat dhe detyrat prindërore ndaj fëmijëve janë:

1. Caktimi i emrit. Me emër personal kuptojmë emrin dhe mbiemrin e fëmijës. Dy prindërit me marrëveshje caktojnë emrin e fëmijës. Në qofte se prindërit nuk dakordohen për emrin e fëmijës, emrin e fëmijës e cakton organi i kujdestarisë.

nëse prindërit kanë mbiemra të ndryshëm të gjithë fëmijët duhet të mbajnë mbiemrin e njëjtë pra ta marrin mbiemrin e vetëm njërit prind. Nëse prindërit nuk dakordohen me marrëveshje mbiemrin e fëmijës e cakton organi i kujdestarisë pasi që të ketë dëgjuar të dy prindërit.

2. Ruajtja dhe mirërritja e fëmijëve. Të dy prindërit janë të detyruar që bashkërisht të kujdesen për jetën dhe shëndetin e fëmijës. Prindërit kanë për detyrë që të kujdesin që fëmijët të mos bëjnë gabime për shkak të moshës së re. Fëmijët me zhvillim të metë mental apo fizik kanë të drejtë në kujdes të posaçëm, që të sigurohet jetë e dinjitetshme dhe pjesëmarrja aktive në aktivitetet shoqërore.
3. Arsimimi dhe edukimi të dy prindërit kanë për detyrë që të kujdesin për arsimimin dhe edukimin e fëmijëve, në mënyrë që ata të përvetësojnë nga sistemi i vlerave pozitive të shoqërisë. Prindërit në përputhje me prirjet, aftësitë dhe dëshirat e fëmijëve e zgjedhin shkollën dhe shkollimin e fëmijëve. Fëmijët duhen të edukohen që të bëhen qytetar të denjë të shoqërisë, të ndërgjegjshëm, patriot, luftëtar për çështjet e atdheut.
4. E drejta e mbajtjes dy prindërit janë të detyruar që ti mbajnë fëmijët e tyre. Me mbajtje kuptojmë të gjitha shpenzimet për ushqim, veshë mbathje, banim, edukim, shkollim dhe shërim të fëmijëve. Prindërit kontribuojnë në proporcion me mundësit e tyre ekonomike dhe me nevojat e fëmijëve. Është i detyruar të jep mbajtje edhe prindi që nuk jeton bashkë me fëmijën, kur me rastin e zgjidhjes së martesës fëmija i besohet në përkujdesje, mbajtje dhe edukim prindërit tjetër.
5. Përfaqësimi, prindërit e përfaqësojnë fëmijën deri sa fëmija e fiton moshën madhore dhe zotësinë e veprimt, prindërit quhen përfaqësues ligjor ngase detyrimi për

përfaqësimin e fëmijëve buron nga ligji. Për kryerjen e ndonjë veprimi juridik në interes të mbrojtjes së të drejtave të fëmijës veprimet i ndërmerr vetëm njëri prind. Prindi i pakënaqur me veprimet e ndërmarra nga prindi tjetër ka të drejt të bëjë prapsim, por prapësimi nuk zhvlerëson veprimet e kryera nga prindi tjetër. Fëmija mbi moshën 14 vjeçare e fiton zotësinë e kufizuar të veprimit dhe disa veprime juridike mund ti ndërmerr edhe vetë.

Përfaqësuesi ligjor i fëmijës disa veprime juridike si tjetërsimi i pasurisë së fëmijës vënien e hipotekës, pengun etj. Nuk mund ti ndërmerr pa pëlqimin e organit të kujdestarisë. Prindërit nuk mund ti përfaqësojnë fëmijët e tyre në veprimet juridike të cilat janë të lidhura ngushtë me personalitetin e fëmijës, si lidhjen e martesës, njohjen e atësisë etj.

E DREJTA TRASHËGIMORE

RANSANKSIONET NDËRMJET TË GJALLËVE (INTER VIVOS)

Paraardhësi me anë të veprimit juridik mund t'u cedojë dhe pjesëtojë pasurinë e vetë pasardhësve të tij. Kërkohet të plotësohen këto kushte:

- Që të pajtohen të gjithë pasardhësit dhe bashkëshorti/ja e paraardhësit,
- Që marrëveshja e cedimit dhe pjesëtimit të bëhet me shkrim
- Që të vërtetohet në gjykatë

Kur pasuria dhe pjesët e cedura të pasurisë konsiderohen si dhurime:

- Po qe se ndokush prej pasardhësve nuk e ka dhënë pajtimin për lidhjen e kontratës,
- Po qe se paraardhësit i ka lindur fëmija pas cedimit dhe pjesëtimit të pasurisë trashëgimore,
- Po qe se është kthyer ndonjë pasardhës që ka qenë i shpallur si person i zhdukur për të vdekur

Ruajta e së drejtës se uzufruktit

Paraardhësi mund t'i ruaj disa të drejta dhe barrë nga fusha e së drejtës së detyrimeve dhe reale për vetën e tij ose bashkëshortin e vetë, si:

- Të drejtën e uzufruktit,
- Pagesën e rentës së përhjetshme në natyrë ose në të holla,
- Mbajtjen e përhjetshme
-

Shuarja e kontratës mbi cedimin dhe pjesëtimin e pasurisë trashëgimore

Kjo kontratë shuhet me:

- Me marrëveshje
- Me denoncimin e kontratës me anë të gjykatës
- Kur pasardhësit nuk i kryejnë detyrimet ndaj paraardhësit, si nuk e paguajnë renten ose mbajtjen e përjetshme.

TRASHËGIMI ME TESTAMENT

Testamenti është një veprim juridik i njëanshëm i kryer nga vetë trashëgimlënësi, me anë të të cilit ky disponon pasurinë për kohën pas vdekjes.

Testamenti nuk ka qernë mjaft i zhvilluar te shqiptarët për shkak se kanë ekzistuar familjet e mëdha me pronësi kolektive, kanë jetuar gjatë në vëllazëri dhe në fise. Motivet për bërjen e testamentet janë respekti dhe dashuria, miqësia dhe simpatia, mirënjohja në shenjë të ndihmës dhe përkrahjes.

Përmbajtja e testamentit

Testamenti përmban urdhra që dalin nga përmbajtja e testamentit, si:

- Caktimin e trashëgimtarëve, që do ta trashëgojë pasurinë e trashëgimlënësit, ose për përjashtimin e ndonjë trashëgimtari nga pasuria trashëgimore,
- Caktimi i trashëgimtarëve testamentar që do t'u kalojë pasuria trashëgimore me testament,
- Caktimi i pasurisë trashëgimore,
- Caktimi i detyrave me të cilat ngarkohen trashëgimtarët ligjor ose testamentar,
- Caktimin e legut dhe të legatarit,
- Caktimin e ekzekutorit të testamentit.

VEÇORITË THEMELORE TË TESTAMENTIT JANË

- Testamenti është akt rigorozë personal;
- testamenti është punë juridike mortis causa;
- testamenti është punë juridike bamirëse;
- testamenti është punë juridike e njëanshme;
- testamenti është akt formal juridik.

Revokimi i testamentit

Revokimi testamentit është akt unipersonal i trashëgimlënësit. Në çdo kohë trashëgimlënësi mund ta revokoj tërësisht ose pjesërisht testamentin e tij. Testamenti mund të revokohet me agjasim p.sh me djegien ose edhe grisjen apo shlyerjen e testamentit. Testamenti me një datë të mëvonshme lënë pafuqi juridike testamentin me një datë të mëhershme nëse:

- a) me dispozitat e testamentit të mëvonshëm kërkohet shprehimisht revokimi i testamentit të mëparshëm dhe

- b) dispozitat e testamentit të mëvonshëm janë në kundërshtim me dispozitat e testamentit të mëparshëm

Testamenti mund të revokohet edhe me një deklaratë të testatorit para gjykatës apo noterit.

Testamenti mund të revokohet tërësisht ose pjesërisht.

Zotësia për të bërë testament

Zotësinë për ta bërë testamentin e ka personi fizik i cili plotëson dy kushte të parapara me testament:

- a) që të ketë mbushur 18 vjet ose 16 vjet dhe të jetë i martuar
- b) të ketë fituar zotësinë e veprimit.

Të dy kushtet duhet të plotësohen në mënyrë komulative.

Pavlefshmëria e testamentit.

Një testament mund të jetë absolut nul dhe relativ nul.

Testamenti absolut nul ekziston kur është bërë me kanosje, shtërgim, mashtrim, lajthim; kur i mungon forma e kërkuar me dispozita ligjore; kur mungon lëria e vullnetit të testatorit për përbërjen e testamentit.

Me testamentin absolut nul cenohen interesat e përgjithshme shoqërore dhe për pavlefshëmrinë e testamentit gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Testamenti relativ nul

Testamenti është relativ nul nëse shkaqet e nulitetit cenojnë vetëm interesat e individëve të caktuar. Për shkaqet e nulitetit relativ gjykata nuk kujdeset sipas detyrës zyrtare, por personat interesat e të cilëve janë cenuar mund të kërkojnë vet nulitetin e testamentit.

Ruajtja e testamenti

Me ruajtje të testamentit kuptojmë ruajtjen e shkresave që përbëjnë përmbajtjen e testamentit.

Testamenti mund të ruhet nga vetë testatori, të një person i besuar i testatorit, në institucione për depozita në bankë, në postë. Mënyra më e sigurt është ruajtja e testamentit në gjykatë.

Interpretimi i testamentit

Me interpretim të testamentit kuptojmë gjetjen e qëllimit të vërtet të testatorit të manifestuar në deklaratën e vullnetit të fundit. Ekzistojnë dy metoda për interpretimin e testamentit: ajo objektive dhe subjektive, metoda objektive është më pak e përshtatshme për interpretimin e testamentit, kurse metoda subjektive është më e përshtatshme ngase me anë të kësaj metode pikë

së pari bëhet interpretimi i kushteve të plotfuqishmërisë të testamentit e pastaj edhe forma e testamentit.

LEGU

Legu është urdhër në testament e trashëgimlënësit me të cilin legatarit i lenë një ose më shumë sende apo të drejta dhe e urdhëron trashëgimtarin ose personin tjetër, të cilit i le ndonjë përfitim nga pasuria trashëgimore, që nga ajo që i është lënë me testament ti jap ndonjë send një personi të caktuar, ti paguaj një shumë të hollash, ta liroj nga ndonjë borxh e ta mbaj ose në përgjithësi të bëjë diçka, të përmbahet nga ndonjë veprim ose të fitoj diçka në dobi të tij.

Personat që përfshihen me leg

- testatori (lënësi i legut),
- onerati (personi i ngarkuar me detyrimin e përmbushjes së legut)
- legatari përfituesi i legut

Përmbajtja e legut

Në përmbajtjen e legut përfshihet caktimi i një ose më shumë legataveve si suksesor singular,

Të drejtat dhe sendet që janë në qarkullim dhe kanë ndonjë vlerë dhe përbëjnë objektin e së drejtës së detyrimeve.

LEGU I LËNË INSTUTUCIONEVE PUBLIKE

Për ta shpëtuar shpirtin në botën e amshueshme, banorët bënë testament në favor të kishës apo të varfërve. Sendi i leguar i lihet institucionit apo organit të caktuar publik dhe me atë rast legatari ka të drejtën e caktimit të qëllimit të përdorimit të pasurisë.

Heqja dorë nga legu

Heqja dorë nga e drejta e legut në favor të trashëgimtarëve të caktuar ose legatarve nuk është e mundur në procedurë trashëgimore. Vetëm pasi legatari ta ketë realizuar procedurën trashëgimore, me kontratë objektin e legut mund të jep një trashëgimtar apo një personi të tretë.

EKZEKUTIMI I LEGUT

Legatari ka të drejt të kërkoj ekzekutimin e legut nga trashëgimtari, i cili është i detyruar që nga trashëgimi i tij të jep sendin e leguar. Ekzekutori i legut mund të caktohet personi që ka zotësi veprimi.

Detyrat e ekzekutorit të legut janë: ruajtja e pasurisë trashëgimore, administrimi i pasurisë trashëgimore, pagimi i borxheve dhe legeve për realizimin e vullnetit të fundit në tërësi ashtu si ka urdhëruar testament lënësi në testament.

Shpenzimet e ekzekutorit të legut kanë të bëjnë me shpenzimet për punën e bërë nga ana e ekzekutorit dhe për shpenzimet e procedurës. Lartësinë e shpenzimeve e cakton gjykata.

Shuarja e legut

Legu shuhet në qoftë se legatori vdes para trashëgimlënësit, heq dorë nga legu ose është i padenjë për të trashëguar. Legu shuhet edhe kur trashëgimlënësi ka shpenzuar objektin e legut ose ky objekt vet vetiu ka pushuar së ekzistuari deri sa ka qenë gjallë testatori ose rastësisht është asgjësuar pas vdekjes së tij.

Afati subjektiv i parashkrimit të legut është 1 vit, ndërsa afati objektiv i parashkrimit është 3 vjet nga dita kur legatari ka marr në dijeni të drejtën e vetë ose ka qenë i autorizuar për kërkimin e ekzekutimit të legut. Në rast parashkrimi objekti i legut përfundimisht i takon oneratit përkatësisht ekzekutorit të legut.

LLOJET E TESTAMENTEVE

Varësisht nga forma që kërkohet me ligj për vlefshmërinë e testamentit, testamentet ndahen në:

- a) testamentin me shkrim dhe testamentin me gojë,
- b) testamentin privat dhe testamentin publik dhe
- c) testamentin e rëndomtë, të jashtëzakonshëm dhe të veçantë

testamenti me shkrim është ai testament i cili shkruhet nga vetë testatori, nënshkruhet dhe datohet. Mjetet me të cilat shkruhet testamenti janë ngjyra, lapsi, shkumësi, apo mjetet tjera të ngjashme. Objekti i shkrimit të testamenti mund të jetë letra, pëlhura, ndërsa, rrasa e gurit ose ndonjë mjet tjetër i përshtatshëm.

Testamenti i shkruar nga vetë testatori quhet testament holograf.

Testamenti i shkruar në prani e dëshmitarëve alograf.

Kur është fjala për testamentin e shkruar para dëshmitarëve, dikush tjetër e shkruan tekstin e testamentit, ndërsa testatori e lexon në prani të dy dëshmitarëve në gjuhën që ata e kuptojmë dhe deklaron para tyre se ky është testamenti që testamenti të jetë i vlefshëm duhen të plotësohen këto kushte:

- që testatori të dijë të shkruaj dhe të lexojë,
- që testatori ta ketë nënshkruar tekstin e testamentit me dorën e vetë dhe
- para dy dëshmitarëve të cilët e kuptojnë gjuhën e testamentit të ketë deklaruar se ky është testamenti i im.

Testamenti me gojë

Testatori mund të deklaroj vullnetin tij të fundit me gojë para dy dëshmitarëve vetëm kur për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme nuk është en gjendje të bëjë testamentin me shkrim. Si rrethanë të jashtëzakonshme duhet kuptuar tërmetin, zjarrin, luftën, epideminë etj.

Dëshmitarët e testamentin me gojë nuk është e domosdoshme të dinë të shkruajnë dhe të lexojnë, por është e domosdoshme që të kenë të shëndosha shqisat e të pamurit dhe të dëgjuarit.

Dëshmitarët e testamentit me gojë kanë për detyrë që në afatin prej 30 ditësh nga pushimi i rrethanës së jashtëzakonshme të shkojnë në gjykatë dhe ta bëjnë përsëritjen e deklaratës të bërë me gojë të testatorit para gjykatës, apo që ta dorëzojnë deklaratën me shkrim të përpiluar me rastin e deklarimit të vullnetit të fundit të testatorit.

Testamenti publik

Testamenti publik është ai testament ku është e domosdoshme për vlefshmërinë tij që të merr pjesë me rastin e përpilimit të tij gjyqtari, përfaqësuesi konsular diplomatik, kapiteni i anijes apo organi tjetër zyrtar.

Testamenti gjyqësor është përfaqësuesi më tipik i testamentit publik, ku testatori shkon në gjykatë dhe para gjykatësit bënë deklarimin e vullnetit të tij të fundit, ndërsa gjykatësi e përpilon tekstin e testamentit sipas tregimit të testatorit. Ekzistojnë dy trajta të testamenti gjyqësor:

- testamenti gjyqësor kur testatori din të lexojë dhe
- kur testatori nuk din të lexojë.

Testamenti kur testatori din të lexojë, pas përpilimit të tij nga gjykatësi sipas tregimit të testatorit, i jep testatorit tekstin e testamentit që ta lexojë. Kur ta lexon testatori ai deklaron se ky është teksti i testamentit tim dhe e nënshkruan. Ndërkaq kur testatori nuk din të lexoj, duhet të jenë të pranishëm me rastin e përpilimit të testamentit dy dëshmitar. Gjyqtari e lexon tekstin e testamentit dhe kur testatori deklaron se ky është testamenti im, e vënë shenjën e gishtit, e nënshkruan gjyqtari dhe dy dëshmitarët e pranishëm dhe në këtë mënyrë merr fund procedura e bërjes së testamentit.

Testamenti në anije dhe testamenti konsular diplomatik gjithashtu janë teste publike dhe përpilohen sipas rregullave të testamentit gjyqësor. Dallimi i vetëm ka të bëjë me atë se në vend të gjyqtarit te testamenti në anije merr pjesë kapiteni i anijes ndërsa te testamenti konsular diplomatik konsulli përkatësisht ambasadori i vendit tonë i akredituar në shtetin e huaj ku bëhet testamenti. Edhe testamenti luftarak është testament publik dhe në vend të gjyqtarit në rastin e përpilimit të tij merr pjesë komandanti i gjetës si epror ushtarak.

Testamenti luftarak dhe në anije janë të kufizuar me kohë. Testamenti luftarak zgjat 30 ditë nga dita e demobilizimit individual të personit ushtarak apo 60 ditë nga mbarimi i luftës.

Testamenti në anije vlen 30 ditë nga dita e kthimit të testatorit në atdhe.

PROCEDURA E SHQYRTIMIT TË PASURISË TRASHËGIMORE

Procedura trashëgimore paraqet një tërësi veprimesh të ndërmarra nga gjykata për vërtetimin e pasojave juridike të trashëgimisë pas vdekjes së trashëgimlënësit dhe për caktimin e masave dhe veprimeve për mbrojtjen e pasurisë trashëgimore si dhe të drejtave që prej saj burojnë.

Procedura për shqyrtimin e trashëgimisë i ka parimet e veta të cilat janë rregulla që burojnë nga normat ligjore me të cilat rregullohet aktiviteti i subjekteve të procedurës që kryejnë veprimtari procedurale me qëllim të mbrojtjes juridike të të drejtave subjektive lidhur me pasurisë trashëgimore. Parimet e së drejtës trashëgimore janë:

- parimi i urgjentitetit që nënkupton se shqyrtimi i trashëgimisë duhet të vendoset sa më parë edhe të vërtetohen drejt të drejtat e trashëgimtarëve lidhur me pasurinë trashëgimore.
- Parimi i socialitetit që nënkupton detyrimin e gjykatës që të kujdeset veçanërisht për realizimin dhe për mbrojtjen e të drejtave të personave të mitur dhe personave të sëmur mentalisht.
- Parimi i zyrtaritetit që do të thotë se gjykata e fillon procedurën për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore po sa të informohet se një person ka vdekur ose është shpallur si i vdekur.
- Përrjashtimi i parimit të drejtpërdrejtshmërisë që nënkupton që aktvendimi mund të mbështet edhe në prova që nuk janë administruar përpara gjykatës e cila e jep mendimin. Nuk do të thotë se gjyqtari ka të drejt ta mbështet aktvendimin në çfarëdo prove që atij i bien ndërmend, por ai këtë mund ta bëjë vetëm në prova të cilat janë të lidhura drejtpërdrejt në çështjet e objektit të trashëgimisë.

Kompetenca e gjykatës

Kompetenca e gjykatës trashëgimore caktohet në bazë të tri kritereve themelore:

- a) Vendi kur trashëgimlënësi e kishte vendbanimin në kohën e vdekjes;
- b) Vendi ku trashëgimlënësi e kishte vendqëndrimin në kohën e vdekjes;
- c) Vendi ku ndodhet pasuria trashëgimore e trashëgimlënësit ose pjesa më e madhe e saj në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit.

Për shqyrtimin e trashëgimisë kompetente në pikëpamje lëndore është gjykata themelore e cila përbëhet në trup gjykues prej 1 gjyqtari ndërsa në shkallë të dytë vendos sipas ankesës Gjykata e Apelit të Kosovës në kolegji të përbërë prej 3 gjyqtarëve profesionist.

Përgatitja e seancës trashëgimore.

Qëllimi kryesor i seancës përgatitore është mënjanimi i pengesave për mbajtjen e seancës trashëgimore para mbajtjes së seancës përgatitore duhet të kryen këto veprime paraprake:

- a) Përpilimi i aktvdekjes
- b) Caktimi i masës së përkohshme për sigurimin e pasurisë trashëgimore
- c) Regjistrimi dhe vlerësimi i pasurisë trashëgimore
- d) Emërimi i kujdestarit të përkohshëm të pasurisë trashëgimore.

Aktivdekjen e përpilon shërbimi kompetent i gjendjes civile dhe brenda 15 ditës ka për detyrë t'ia dërgoj gjykatës për fillimin e procedurës për shqyrtimin e pasurisë. Nëse trashëgimlënësi është shpallur i person i zhdukur për të vdekur aktivdekjen e përpilon gjykata e cila e ka marr lëndimin.

Regjistrimi dhe vlerësimi i pasurisë trashëgimore bëhet me qëllim të sigurimit të pasurisë, që ajo të jetë e mbrojtur nga vjedhja, fshehja ose asgjësimi. Regjistrohen si borxhe ekzistuese ashtu edhe pasuria të cilin e kishte trashëgimlënësi në momentin e vdekjes së tij.

Masa e përkohshme për sigurimin e pasurisë trashëgimore mund të caktohet gjatë gjitha fazave të shqyrtimit të trashëgimisë deri në përfundim të procedurës me aktvendim të plotfuqishëm. Arsyeja për caktimin e kësaj mase është rreziku që i kërcënohet shkatërrimit të pasurisë trashëgimore ose vjedhjes së saj.

Ankesa kundër vendimit për caktimin e pasurisë trashëgimore nuk e ndal ekzekutimin e vendimit.

Seanca trashëgimore.

Në seancën trashëgimore gjykata shqyrton të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pasurinë e trashëgimlënësit, veçmas të drejtës të trashëgimit të trashëgimtarëve, madhësisë së pjesës trashëgimore dhe të drejtës së legatarit. Deri në mbarim të seancës trashëgimore trashëgimtari mund të heq dorë nga pjesa trashëgimore që do ti takonte apo të deklarojë se e pranon trashëgiminë.

UDHËZIMI I PALËVE NË KONTEST CIVIL

Gjykata do të ndërpres shqyrtimin e pasurisë trashëgimore dhe do ti udhëzojë palët që ta fillojnë kontestin në gjykatë ose procedurën në organin administrativ nëse faktet nga të cilat varet e drejta e trashëgimisë janë kontestuese, nëse faktet nga të cilat varet madhësia e pjesës trashëgimore janë kontestuese nëse faktet nga të cilat varet themelësia ligjore e përjashtimit të trashëgimisë dhe e heqjes dorë nga trashëgimia janë kontestuese. Me këtë rast gjykata do ta ndërpresë procedurën dhe do ta udhëzojë palën që ta fillon procedurën kontestimore apo administrative në afatin prej 30 ditësh nëse pala në afatin e caktuar nuk vepron sipas aktvendimit të gjykatës do të vazhdojë shqyrtimi i pasurisë trashëgimore pa i marr parasysh kërkesat, lidhur me të cilat pala është udhëzuar në kontest.

Aktivendimi për trashëgimi

Gjykata trashëgimore vendos me aktvendim për shqyrtimin e trashëgimisë. Aktivendimi duhet të përmbajë emrin dhe mbiemrin e trashëgimlënësit, të trashëgimtarëve pasurinë trashëgimore si dhe

pjesët që u takojnë trashëgimtareve të shprehura në thyesa. Aktvendimi për shqyrtimin e trashëgimisë përbëhet gjithashtu nga hyrja dispozitivi dhe arsyetimi.

Kundër aktvendimit është e lejuar ankesa.

Aktvendimi i pjesshëm i shqyrtimit të trashëgimisë.

Pasi të konstatoj se cilat pjesë të pasurisë trashëgimore nuk janë kontestuese, gjykata mund që për ato pjesë ti shpallë trashëgimtarët e pasurisë trashëgimore, kurse për pjesët kontestuese palët i udhëzoj në procedurë kontestimore.

Pasuria e gjetur pas marrjes së aktvendimit për trashëgimin.

Po që se është gjetur një pasuri e trashëgimlënësit pasi që është shqyrtuar pasuria trashëgimore për të cilin pasuri nuk është ditur në momentin e marrjes së aktvendimit për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore atëherë gjykata nuk do ta shqyrtoj përsëri pasurinë trashëgimore që e ka shqyrtuar njëherë, por pasurinë e gjetur me një aktvendim të ri do ta pjesëtoj në mbështetje të aktvendimit të mëparshëm të trashëgimisë.

Gjetja e testamentit pas plotfuqishmërisë së aktvendimit për trashëgimisë

Testamenti i gjetur pasi të jetë bërë i plotfuqishëm aktvendimi për trashëgiminë apo aktvendimi për legatarin ka kuptimin e faktit të ri prandaj gjykata do të udhëzoj palët në procedurë kontestimore për ti realizuar të drejtat e tij.

Mjetet e goditjes

Mjetet e goditjes janë dy llojesh:

- a) Të zakonshme dhe
- b) Të jashtëzakonshme

Mjet i zakonshëm i goditjes së aktvendimit për trashëgiminë është ankesa. Pala e pakënaqur mund të parashtrij ankesë kundër aktvendimit në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, ankesa i dorëzohet gjykatës së shkallës së parë për Gjykatën e Apelit të Kosovës.

Mjet i jashtëzakonshëm i goditjes së aktvendimit për shqyrtimin e trashëgimisë është: revizioni dhe kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë. **Revizioni lejohet në dy raste:**

1. Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë me të cilin hudhet poshtë ankesa dhe
2. Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë me të cilin vërtetohet se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e parashtron prokurori i shtetit kur konstatohet se është shkelur ligji material ose procedural.